

Të shtëna me armë zjarri në Podujevë, plagoset një person

LAJME



12/06/2022 21:32

f

t

l

Të shtëna me armë zjarri ka patur sonte në rrugën “Zahir Pajaziti” në Podujevë.

Si pasojë e këtyre të shtënave me armë i plagosur ka mbetur një person.

Kjo është konfirmuar për [lajmi.net](#) nga zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Agron Borovci.

“Rreth orës 20:00 është pranuar informacioni për të shtëna me armë zjarri në rrugën “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe mbështetur në të dhënat e para, bëhet e ditur se një person ka marrë plagë nga arma e zjarrit”, tha ai.

Personi i plagosur në këtë rast është dërguar në QKUK, për të marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor.

“Aktualisht hetuesit policor kanë nisur një hetim për sqarimin e të gjitha rrethanave që karakterizojnë rastin”, shtoi Borovci./[Lajmi.net](#)/

Artikuj të ngjashëm



June 12, 2022

Vuajtjet e nënave në luftë, në rrëfimin e gruas ikonë të dëbimit



June 12, 2022

Fermeri nga Krusha: Nuk po gjej punëtorë me pagë 420 euro




June 12, 2022

Eksperti britanik: Serbia po e përgatit ‘recetën ruse’ për t’i paraqitur...



June 12, 2022

Zgjedhjet në Francë: Aleanca e Majtë dhe Macron pothuajse të barabarta



June 12, 2022

Tërmet në Turqi



June 12, 2022

Krasniqi: Tregoni Gërvallës e Kurtit se edhe mund ta injoroni UÇK-në,...